

LIGJ
Nr. 146/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 52/a togfjalëshi “319/c dhe 328” zëvendësohet me togfjalëshin “dhe 319/c.”

Neni 2

Pas nenit 52/a, shtohet neni 52/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 52/b

Përfshirja nga dënimi për krimet në fushën e zgjedhjeve

Personi që ka kryer një ose më shumë vepra penale të parashikuara në kreun X, të këtij Kodi, i cili bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale për hetimin, si dhe për zbulimin e personave të tjerë, bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale ose autorë të veprave të tjera të lidhura, përfshirë nga dënimi për veprën penale të kryer prej tij.”.

Neni 3

Pas nenit 154, shtohet neni 154/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 154/a

Shkatërrimi i ndërtesave dhe objekteve të tjera

Kryerja me dashje e çdo veprimi tjetër, të ndryshëm me ato të parashikuara nga nenet e mësipërme të këtij seksioni, që mund të sjellë shkatërrimin e plotë ose të pjesshëm të ndërtesës, të objektit qytetar, të veprës industriale, të infrastrukturës apo të çdo objekti tjetër ose që mund të rrezikojë jetën ose shëndetin e njerëzve, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 4

Në nenin 199/a, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:
“Po kjo vepër, e kryer për plotësimin e nevojave për strehim sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.”.

Neni 5

Neni 199/b, ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 199/b

Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i paligjshëm i ndërtimeve

Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i punimeve të ndërtimit në kundërshtim me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit nga persona ndaj të cilëve janë marrë më parë masa administrative për këto shkelje, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Nxitja me ose pa shpërblim, ose detyrimi i projektuesit, mbikëqyrësit, zbatuesit ose kolauduesit të punimeve të ndërtimit për të shkelur rregullat që garantojnë kryerjen e ndërtimeve në përputhje me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 6

Në nenin 328 hiqet togfjalëshi “në kundërshtim me ligjin”.

Neni 7

Në paragrafin e fundit të nenit 328/a hiqet togfjalëshi “në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës”.

Neni 8

Në nenin 328/b hiqet togfjalëshi “në kundërshtim me ligjin”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.12.2020

**Shpallur me dekretin nr. 11904, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**